



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:179091
Datë: 29.05.2024
Numri i dokumentit: 05752173

Ac.nr.67/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji në përbërje nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Naim Mehulli, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve, kundër të paditurit S.Sh , K, të cilin e përfaqëson me autorizim avokati A.F, për shkak të rimbursimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së paditëses dhe të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.182/18, të datës 19.10.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 29/05/2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHEN si të pa bazuar ankesa e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve dhe ankesa e të paditurit S.Sh dhe VËRTETOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.182/18, të datës 19.10.2020.

II.Aktgjykimi ankimuar C.nr.182/18, të datës 19.10.2020, në pikën II i dispozitivit, mbetet e pa shqyrtuara.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.182/18, të datës 19.10.2020 ka vendosur më sa vijon:

I.APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit si e BAZUAR dhe DETYROHET i padituri S.Sh, që paditëses t'ia kompensojë dëmin në shumë prej 1335-€, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të dt.23.04.2015, me kamate ligjore sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e gjer në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të aktgjykimit nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

II. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses mbi shumën e gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe ate në shumë prej 1860-€, si e pabazuar.

III Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër pikës III të dispozitivit të aktgjykimi i autorizuari i paditëses në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, me propozim si në ankesë.

Kundër këtij aktgjykimi, i autorizuar të paditurit, në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim si në ankesë.

Ndërgjyqësit nuk kanë parashtruar përgjigje në ankesën.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesat e ndërgjyqësve janë të pathemelta.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja Byroja Kosovare e Sigurimeve, me datën 25.04.2018, pranë gjykatës së shkallës së parë ka paraqitur padi, kundër të paditurit, për shkak të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e datës 23.04.2015, me arsye sikurse në padi.

Duke vepruar sipas padisë së paditëses, gjykata e shkallës së parë ka filluar procedurën dhe pas marrjes së përgjigjes në padi, vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës ka marrë aktgjykimin e ankimuar me përmbajtje sikurse në dispozitivin e tij. Në arsyetim të aktgjykimit ka theksuar se nga transferi bankar i Bankës Ekonomike dt.02.11.2015 vërtetohet se paditësja ia ka kompensuar të dëmtuarit NPT PBC Kosova, dëmin në lartësi prej 1.860.00 euro, e cila shumë është dakorduar me ujdinë jashtëgjyqësore me nr.505/15 e dt. 12.11.2015. Nga raporti i aksidentit nr.2015-AR-0910 të dt.23.04.2015 së bashku me skicën e vendit të ngjarjes, u vërtetua se ditën kritike ka ndodhur aksidenti i komunikacionit në magjistralen Prishtinë-Ferizaj në udhëkryqin për Janjevë, i cili aksident ka ndodhur në mes të kamionit Iveco me targa 01-876-BM të cilin e drejtonte S.Sh dhe veturës “Citroen” me targa 01-123-FA, e në të cilën aksident janë shkaktuar dëme materiale. Nga konfirmimi i sigurimit me nr. TPL:5425011 të lëshuar me dt. 28.04.2015 u vërtetua se automjeti të cilin e voziste i padituri në momentin e aksidentit ka qenë pa mbulesë siguruese apo me validitet të skaduar të sigurimit, ku vërtetohet se i padituri ka pasur validitet të sigurimit prej dt. 28.04.2015 deri me dt. 28.04.2016. Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit S.B dhënë në ekspertizën e datës 22.02.2020, u vërtetua se shkaktari i këtij aksidenti është vozitësi i automjetit “A” të markës Iveco me targa 163 -876-BM, ku deri të aksidenti ka ardhur kur automjeti A e ka penguar ngasësin e automjetit “B”- të markës “Citroen” me targa 01-823-HN, i cili ishte duke lëvizur në rrugën me përparësi kalimi, respektivisht në rrugën kryesore, kjo si pasoje e mosrespektimit të shenjave “Stop”, rregullave për perparësinë e kalimit në udhëkryq dhe moskujdesit në ngasje, ngasësi i automjetit A ka lëvizur pa i dhënë përparësi kalimi automjetit B pra është kyqur nga rruga dytësore në rrugën kryesore e në këtë mënyrë është shkaktuar aksident komunikacioni, ndërsa ngasësi i automjetit B ka qarkulluar në shiritin e djathtë të komunikacionit, në momentin e aksidentit, ka tentuar të evitojë aksidentin duke u zhvendosur majtas me pjesën e parë ballore e ka goditur autojetin A, ku ngasësi i automjetit B ka lëvizur me shpejtësi 67 km/h në zonën e kufizuar 50 km/h pra shpejtësi joadekuate konform shenjave, rregullave kushteve dhe rrethanave të krijuara në komunikacion, ndërsa ngasësi B me veprimet e tij i ka kontribuar në shkaktimin e aksidentit me shpejtësi të madhe, respektivisht ka kontribuar në rritjen e vëllimit të dëmit. Nga kjo është konstatuar se deri të aksidenti ka ardhur

me lëshimet primare të ngasësit të automjetit "A"- Iveco me targa 01-823-HN të cilin e drejtonte S.Sh për aq sa është përgjegjës është detyruar për rimbursimin e dëmit paditëses, duke marrë parasysh se kjo e fundit e ka kompensuar palën e dëmtuar në shumën e tërësishme prej 1.860.00-€, dhe se i padituri ka përgjegjësi primare, ndërsa pala e dëmtuar i ka dhënë kontribut automjetit në rritjen e vëllimit të dëmit, andaj gjykata ka vlerësuar prej kësaj shume i padituri të detyrohet për shumën prej 1.335.00-€, për aq sa ka qenë përgjegjësia e tij në shkaktimin e këtij aksidenti. Nga ekspertiza e makinerisë të punuar nga eksperti S.B me dt.24.02.2020, për vlerësimin e dëmit në automjet rezulton se vlera e demit material të automjetit Citroen me targa 01-123-FA, në kohën e aksidentit është 1.780.00-€.

Nga këto prova të administruara, të cilave gjykata në terësi ua fali besimin, gjykata erdhi deri te përfundimi se aksidenti në komunikacionin rrugor të dt.23.04.2015, në udhëkryqin e Janjevës, në të cilin i dëmtuari ka pësuar dëm në automjetin e tij Citroen me targa 01-123-FA është shkaktuar me lëshimet primare të ngasësit të automjetit Iveco me traga 01-876-BM, dhe këtij aksidenti i ka dhënë kontribut sekondar edhe drejtuesi i automjetit Citroen, e cila përgjegjësi është vërtetuar nga ekspertiza e ekspertit të komunikacionit të dt.22.02.2020 si dhe mendimi i ekspertit të komunikacionit dhënë në shqyrtimin kryesor të dt.19.10.2020, andaj bazuar në dispozitat e Ligjit për sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjësive dhe atë nën 14.1.2 dhe 3, gjykata gjeti se rrjedh obligimi i të paditurit që paditëses t'ia kompensojë, përkatësisht t'ia rimburojë pjesërisht dëmin material, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në shumë prej 1335-€, për 75% të përgjegjësive së të paditurit S.Sh, pasi i dëmtuari për shkak të mosrespektimit të shenjës së komunikacionit me të cilën është e kufizuar shpejtësia e lëvizjes, ka tejkaluar këtë shpejtësi nga 50km/h sa është e parapare me rregullat e komunikacionit në 67km/h, e në këtë rast i siguruari i paditësit i ka dhënë kontribut sekondar këtij aksidenti, në rritjen e vëllimit të demit në automjet. Me rastin e vendosjes gjykata është bazuar në nenin 18.4 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia e lidhur me nenin 159 par.1 dhe 2, 169 par.2 dhe 176 par.1, 3 dhe 4 të LMD-së, ndërsa lidhur shpenzimet procedurale ka vendosur duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga nenin 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e as në shkeljet e pretenduara me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të pathemelta qëndrojnë pretendimet ankimor të ndërgjyqësve për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, ngase aktgjykimi i ankimuar del se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre, ndërsa në shkresat e lëndës nuk ka prova se paditësja e ka bërë specifikimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore siç parashihet me nenin 463.1 të LPK-së e cila dispozitë parashihet: *Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën.*

Gjykata e Apelit vlerëson se, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të parashtruara nga ana e palës së paditur, pasi që në bazë të mendimit dhe konstatimit të ekspertizës së komunikacionit është vërtetuar në mënyrë bindëse se deri te aksidenti ka ardhur si rezultat të lëshimeve të paditurit i cili është kyçur në rrugën kryesore pa qenë i sigurt si dhe nuk e ka respektuar shenjen e komunikacionit stop dhe gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vlerësuar se i padituri ka lëshime primare në shkaktimin e aksidentit në shkallen prej 75 %, si dhe automjetin e ka drejtuar pa mbulesë të sigurimit dhe si rezultat i këtij aksidenti kanë pësuar dëme pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, ku në bazë të urdhër pagesës, vërtetohet se paditësja e ka bërë kompensimin e dëmit. Sipas nenit 18 par. 1 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, nr.04/L-018 (i cili ka qenë i zbatueshëm në kohën e shkaktimit të aksidentit) është paraparë se “Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i auto përgjegjësive, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja”. Ndërsa në par.4 të këtij neni parashihet se “Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”.

Meqenëse, i padituri nuk ka pasur mbulesë të sigurimit atëherë përgjegjësia e kompensimit ka rënë mbi paditësen, andaj e njëjta konform dispozitave ligjore të sipër theksuara ka të drejtë që të kërkojë rimbursimin për dëmin e paguar ndaj personave të tretë si pasojë e shkaktimit të atij dëmi nga ana e të paditurit. Në rastin konkret i padituri me asnjë provë të vetme, nuk e ka argumentuar të kundërtën e dëmit të pretenduar, andaj gjykata e shkallës së dytë, duke u bazuar në këtë gjendje faktike erdhi në përfundim dhe vërtetoi se ekziston detyrimi juridik-civil, ndaj paditëses për rimbursimin e dëmit.

Pika II e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, nuk është shqyrtuar nga kjo gjykatë, pasi që në bazë të thënieve nga ankesa e ushtruar, kjo gjykatë ka konstatuar se në këtë pjesë aktgjykimi i ankimuar nuk është goditur nga palët ankuese.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat pretendime ishin të paqarta dhe nuk kishin të bëjnë me këtë çështje, dhe nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Ac.nr.67/21, me datë 29.05.2024

Kryetar i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku